

“Roli i institucioneve gjyqësore të pavarura në fuqizimin e profesionalizmit dhe performancës së gjyqësorit”

1 Tetor 2021

E nderuar Kryetare Llagami, i dashur Ministër Manja, Ambasador Soreca, dr. Pratroja, të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni t’ju falenderoj për ftesën tuaj për të marrë pjesë në këtë konferencë të rëndësishme mbi një çështje kyç: si institucionet gjyqësore rregullohen dhe vlerësojnë vetveten për të përmirësuar efikasitetin dhe aftësinë për të dhënë një drejtësi të shpejtë dhe të barabartë.

Sistemi gjyqësor shqiptar ka njohur një proces ndryshimi rrënjësor për t’iu përgjigjur sa më mirë kërkesave, të shprehura shpesh herë në forumet ndërkombëtare, lidhur me efikasitetin dhe papanshmërinë e institucioneve gjyqësore.

Procesi i “vetting-ut”, i parashikuar me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, është shprehimisht i adresuar për këtë qëllim.

Sikurse dihet tashmë, arsyeja për të cilën u parashikua ky instrument ishte për t’iu përgjigjur nevojës për të “garantuar një funksionim sa më të mirë të drejtësisë, pavarësisë së sistemit gjyqësor si dhe për t’ë rikthyer besimin e publikut tek sistemi gjyqësor.

Në bazë të të dhënave statistikore të disponueshme, procesi i vetting-ut vështirë se do të mund të përfundojë misionin e tij brenda afatit të parashikuar prej 5 vjetësh dhe parashikohet se do të nevojitet ndoshta një zgjatje e mandatit të këtyre institucioneve.

Duke qenë se nevojitet një ligji i ri kushtetues, i kërkoj të gjitha partive politike të parlamentit të ri të punojnë së bashku për të miratuar një ligj që të jetë në interes të popullit shqiptar.

Aktualisht, si rrjedhojë e procedurave të vetting-ut, është e pamundur që të emërohen anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të cilët përcaktohen nga Gjykata e Lartë (3 anëtarë) pasi në përbërje të këtij institucioni ka ende vende bosh të cilat nuk mund të plotësohen me

shpejtësi pasi kandidatët për në Gjykatën e Lartë duhet t'i nënshtrohen procedurave të verifikimit.

Në këto rrethana, roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor mbetet thelbësor në plotësimin e boshllëqeve të sistemit, në mënyrë të veçantë përsa i përket numrit të gjyqtarëve dhe funksionimit më efikas të zyrave të gjyqësorit.

Në këtë kuadër, Kryetari Filippo Donati, Kryetar i Rrjetit Evropian të Këshillit të Gjyqësorit, të cilin e përgëzoj dhe e falenderoj për pjesëmarrjen sot në këtë veprimtari, do të vërë theksin në mësimet kryesore të nxjerra në nivel evropian.

Sikurse të gjithë jeni në dijeni, Italia ka qenë gjithmonë në vijën e parë të mbështetjes për të siguruar funksionimin sa më të mirë të drejtësisë, të pavarësisë së sistemit gjyqësor si dhe të rikthimit të besimit të publikut tek sistemi gjyqësor.

Për këtë arsye, bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor ka qenë gjithmonë i ngushtë.

Synimi për të rritur dhe për të përmirësuar cilësinë dhe profesionalizmin e Magjistratëve (Gjyqtarëve dhe Prokurorëve shqiptarë) është një objektiv kyç dhe i përbashkët.

Ky bashkëpunim ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme e domethënëse, si në fushën e formimit dhe edukimit të magjistratëve të rinj ashtu edhe në atë të shkëmbimit të ndërsjelltë të përvojave më të mira në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore.

Si asnjëherë më parë gjatë kësaj periudhe historike, rrugëtimi që bashkon të dy sistemet gjyqësore, atë italiane dhe atë shqiptare nuk ka qenë kaq i dukshëm dhe kaq konkret. Mund të përmendja këtu një sërë shembujsh të bashkëpunimit tonë të frytshëm.

Po mjaftohem duke përmendur konferencat e organizuara nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë Kombëtare të Antimafias dhe anti terrorizmit.

Edhe në këtë rast, bashkëpunimi në frontin e luftës ndaj krimit të organizuar, trafikut të drogës, pastrimit të parave dhe korrupsionit është realizuar falë punës së përditshme të Prokurorive italiane përkrah atyre shqiptare.

Protokolli i bashkëpunimit mes Drejtorisë Kombëtare të Antimafias dhe SPAK-ut, nënshkruar në vitin 2020, përbën një tjetër shembull të angazhimit të përbashkët për të luftuar krimin e organizuar si në Itali ashtu edhe në Shqipëri.

Është plotësisht aktiv një numër i konsiderueshëm i Skuadrave Hetimore të Përbashkëta (mesatarisht rreth 10 çdo vit aktive në të dy territoret) ndërsa aspekte të tjera të dobishme të kësaj marrëveshjeje kanë gjetur zbatim në vazhdimësi në përcaktimin e ndjekjeve penale (hetimore dhe njoftimin e akteve).

Është aktivizuar tashmë procedura për vijueshmërinë në Shqipëri të masave me burgim të dhëna në Itali në ngarkim të shtetasve shqiptarë.

Me pak fjalë, falë instrumenteve në fuqi si në rrafshin dypalësh ashtu dhe atë shumëpalësh, bashkëpunimi gjyqësor mes Italisë dhe Shqipërisë ka arritur nivele të jashtëzakonshme.

Do të dëshiroja të përfundoja fjalën time duke ju siguruar se kontributi i rëndësishëm që Itali i ka dhënë Shqipërisë për t'i siguruar këtij Vendi një sistem gjyqësor në lartësinë e pritshmërive të qytetarëve, do të vijojë edhe në të ardhmen. Puna jonë e përbashkët do të vijojë më tej.

Faleminderit.